



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:206247

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05436121

P.nr. 979/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuares **F.E.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes te Prokurorise Themelore te shtetit në Prizren PP.nr.1502-13/2023, të datës 28.09.2023, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore publike, në prezencën e Prokurorit Themelore te shtetit në Prizren Merita Gaka, të akuzuares, me datë **28.02.2024**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

AKT GJYKIM

E akuzuara **F.E.**, nga i ati, dhe e ëma, e vajzërisë, e lindur më dt.në Prizren, ku edhe tani jeton ne rr..... nr....., ka të kryer shkollen e mesme, refere sporti, e pamartuar, e gjendjes se mesme ekonomike, turke, shtetase e Republikës së Kosoves, me nr.pers.

ESHTË FAJTORE

Me datë 27.06.2023, rreth orës 18:30, në rr. “Jusuf Gervalla” në Prizren, saktësisht në lokalit “.....”, e pandehura, pas një fjalosjeje paraprake që kishte me të dëmtuarën L.R., të njëjtën e kishte shtyrë duke i thënë “liroma rrugën”, e më pastaj e kishte goditur me shuplakë në fytyrë e cila ishte rrëzuar, mirëpo nuk janë konstatuar lëndime trupore tek e dëmtuara në mungesë të raportit mjekësor.

Me këto veprime e ka kryer veprën penale: Sulmi nga neni 184 par. 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43,69, 70, 71, 72 te KP-se, dhe nenit 184 par.1 te KP-se, dhe nenit 364 te KPPK-es, te akuzuares i shqipton:

D E N I M E G J O B E

Ne lartesi prej **200 /dyqinde/ eurove**, te cilen shume te denimit eshte i obliguar qe te paguaje ne afat prej 30 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejti do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo **20** euro nje dite burg, rrespektivisht denim burgimi prej 10 diteve,

E akuzuara obligohet që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ndërkaq në emër të paushallit gjygjësor shumë prej **20 euro**, si dhe ne emer te kompenzimit per viktimat e krimit shumen prej **20 eurove**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kerçnim te ekzekutimit te dhunshem.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me nr. PP.nr.1502-13/2023 te dt.28.09.2023, kunder te akuzuares F.E., nga Prizreni, per shkak te vepres penale sulmi nga neni 184 par.1 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim gjyqesor fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares e cila vullnetarisht e ka pranuar fajsin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se e akuzuara ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajit per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat e akuzuara ka qene e njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares eshte bere ne pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nenpar.2.1, 2.2, 2.3, 2.4 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuares formohen te gjitha elementet e vepres penale, sulmit nga neni 184 par.1 te KP-es, dhe per kete gjykata te akuzuaren e shpalli fajtoresh dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuares gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 69 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuares, e ne kuptim te dispozitave te nenit 70, 71 e 72 e akuzuara ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i sajë ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin ne menyre vullnetare, pa kurfar kushtezimi e ndikimi nga jashte, si dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i sajë duke premtuar se asnjehere nuk do te perserise veper penale te tille, gjer me tani te pa gjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe te akuzuares, sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit se me kete mase sanksionuese do te arrihet efekti preventiv i parandalimit te kryeresve te veprave penale, si dhe duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se sajë, dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete me e kujdesshme dhe do te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit penalo-juridik.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 454 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Deparatamenti i pregjithshem penal
P.nr.979/2023 të datës 28.02.2024

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 30 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.